

KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL

KOMPANIA E UJËSJELLËSIT RAJONAL SH.A.

HIDRODRINI

SH.A. - PEJË
Nr. 718 Data: 15.08, 2022

HIDRODRINI

Zyret qendrore
Rr. Lekë Dukagjini Nr. 156 30000 Pejë Telefoni:
039 / 432 355
www.hidrodrini.com

Bazuar në nenin 8 të Ligjit Nr.03/L-212 të Punës, nenit 4 të UA 07/2017 për rregullimin e procedurave të konkursit në sektorin publik nenit 4 të Rregullores mbi Marrëdhënjen e Punës të punëtorëve të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Pejë, KRU "Hidrodrini" Sh. A. publikon këtë:

K O N K U R S

Pozita: Mirëmbajtëse/Pastruese NjO Pejë

Ekzekutues: 1 (Një)

Kohëzgjatja e Kontratës: Kontrata lidhet për kohë të caktuar (6 mujore), me mundësi vazhdimi varësisht nga angazhimi i të punësuarit.

Detyrat dhe përgjegjësitë:

- Mirëmbajtja e përgjithshme e objektit dhe sigurimi i nivelit të lartë të pastërtisë në të gjitha hapësirat e objektit;
- Kujdesi dhe mbajtja e pastërtisë në të gjitha zyret e punës, duke përfshirë pastrimin e rregullt të tyre dhe inventarit;
- Pranimi i materialit higjienik dhe përkujdesja për të;
- Kujdeset për mjetet e punës dhe raporton për defektet e tyre;
- Bënë ajrosjen e ambientit punues;
- Kujdesi i rregullt ndaj luleve brenda dhe jashtë objektit;
- Si dhe detyra të tjera të caktuara nga punëdhënësi;
- Raporton për punën të përgjigjësi i administratës dhe Kryeshefit Ekzekutiv;

Kërkesat/Kualifikimet Profesionale:

- Diploma e shkollës së mesme;
- Të ketë përvojë pune në kohëzgjatje prej 1 viti, në punë të ngjajshme;
- Të ketë aftësi të mira komunikuese;
- Kopja e letërnjoftimit;
- Çertifikatën që kandidati nuk është nën hetim;
- Dëshmi për përvojën e punës;

Aplikacionet mund të merrenë në zyrën Burimeve Njerëzore të KRU "Hidrodrini" Sh. A. Rr "Lekë Dukagjini" Nr.156 Pejë dhe Web – faqen "Hidrodrini" Sh. A. www.hidrodrini.com.

Aplikacionit i bashkangjiten kopje të dokumentacionit mbi kualifikimin, për përvojën e punës, dokumente tjera të nevojshme që kërkon vendi i punës për të cilën konkurrojnë kandidatët. Aplikacioni dhe dokumentet përcjellëse dorëzohen në KRU "Hidrodrini" Sh. A. Zyra e Burimeve Njerëzore në pliko të mbyllur në adresën: Rr. "Lekë Dukagjini" nr.156 - Pejë (afër Patrikanës së Pejës).

Shpallja do të jetë e hapur 15(pesëmbëdhjetë) ditë nga dita e publikimit, në shtypin ditor dhe Web – faqen www.hidrodrini.com

Kandidatët që ftohen në intervistë janë të obliguar të sjellin me vete dokumentet origjinale për verifikim para komisionit intervistues.

Kandidatët që hyjnë në përzgjedhje të ngushtë, do të informohen lidhur me intervistën nëpërmjet telefonit ose me shkrim në afat ligjor nga zyra e Burimeve Njerëzore.

Aplikacionet e derguara pas afatit të cekur më lartë nuk do të pranohen. Dokumentat jo të kompletuara do të refuzohen. KRU "Hidrodrini" Sh. A. ofron mundësi të barabarta të punësimit për të gjithë shtetasit e Republikës së Kosovës.